



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 01**

Datë: 13. 01. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Florian Dushi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoresh, u.d e ZRPPC

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 81, 82, 83 dhe 84/2021.

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së.**

#### **3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**
  - Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Klinë, Zubin Potok, Lipjan, Rahovec, Deçan, Pejë dhe Prizren.
- **Këshilli i Personelit:**
  - Diskutim lidhur me pozitën e zv. Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së.

#### **4. Komiteti i Auditimit:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të KA për vitin 2021.
-

## **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi:** Mirës e keni ardhur në mbledhjen e parë të këtij viti! E keni rendin e ditës. A ka dikush ndonjë propozim ?

**Arianit Elshani:** Lidhur me pikën që ka të bëj me këshillin e personelit, mendoj që kjo pikë duhet të mbahet me dyer të mbyllura, dhe të jetë në fund, mbas pikës së komitetit të Auditimit.

**Sami Kurteshi:** Këshilli ka mbajtur një takim, dhe mendoj se janë dy pika shtesë që duhet të shtohen, pra që nuk kanë qenë në rend dite. 1. Një pikë-propozimi nga ZRPP. 2. Dhe zëvendësime, që kanë ardhur më vonë, pra propozoj që të futen në rend dite.

Në vazhdim, miratohen procesverbalet nr. 81, 82, 83 dhe 84/2021. Në dy mbledhje që nuk ka marrë pjesë, z. Kurteshi, abstenoj.

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**Burim Ahmetaj,** tha se ndër aktivitetet është ndarja buxhetore që merren nga MEF dhe lejimin e qasjes për administrimin e financave. Nuk e kemi aktualisht buxhetin e disponueshëm, mirëpo kjo zgjatë deri sa të mbarohen këto pjesë procedurale. Pasi që të kryhen procedurat, ne mund të fillojmë me të gjitha aktivitetet financiare. E kemi draftuar edhe planin përfundimtar të prokurimit, dhe ne do ta sjellim në mbledhje për miratim nga KQZ. Jemi duke e punuar edhe draft-planin e punës së KQZ 2022, tha z. Ahmetaj, dhe nga punësoria e mbajtur janë disa konkluzione që do të jenë pjesë e draft-planit. Po draftohet edhe kërkesat apo aktivitetet e departamenteve. Po punojmë edhe në plotësim-draftimin e rregullave, si dhe është duke vazhduar regjistrimi i pasurisë jo financiare të KQZ.

Aktivitet tjetër është aktivizimi i Serverit, arkivimi i aktiviteteve dhe materialeve, dokumenteve në fajll-sevver. Janë kompletuar edhe vlerësimet e stafit jo permanent që kanë punuar në zgjedhje, çështjet e pagesave etj.

Lidhur me raportin e Sekretariatit, **Alim Rama** e konsideroi të vonuar Serverin, dhe pyeti se pse dokumenti nuk është gati, pse aty nuk përfshihen vendimet, dhe dokumentet e zyrës së arkivit !

Krye shefi, tha se dokumenti do të kompletohet.

Zoti Rama pyeti sa janë mjetet e kthyer, apo që duhet të paguhen për stafin jo permanent, kurse z. Ahmetaj tha se janë rreth “35 000” euro që duhet të paguhen në ndërkohë!

**Arianit Elshani,** foli rreth planit të draft-punës dhe konstatoi se, sa më parë duhet të kemi këtë plan të kompletuar, duke uruar që viti i ri 2022 të jetë vit edhe më i suksesshëm i punës së KQZ. Në fund të muajit, do të duhej të kishim të finalizuar këtë plan, pra të mos vonohemi...! Ai, foli edhe rreth regjistrimit të pasurisë jo financiare, duke kërkuar që as kjo çështje të mos zhagitet! Z. Elshani, diskutoi edhe rreth serverit, si dhe rreth pagesave.

## **3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **1. Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale në: Klinë, Zubin Potok, Lipjan, Rahovec, Deçan, Pejë dhe Prizren:

**Sami Kurteshi:** E kam kryesuar unë takimin e këshillit. Ne, kemi trajtuar dy pika: Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të anëtarëve të Kuvendeve Komunale. E keni materialit. I kemi shqyrtuar dhe miratuar. Zyra ligjore, thotë se dokumentacioni është në rregull, i kanë kryer procedurat, dhe ne i kemi miratuar në këshill dhe rekomandojmë për aprovim. Pika e dytë, është propozimi i ZRPP-së...por, njëherë të bëhet miratimi i zëvendësimeve...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Klinës, i dorëhequri Qëndrim Millaku zëvendësohet nga Shkruje Shala nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Zubinpotokut, e dorëhequra Latinka Utviq, zëvendësohet nga Goran Radojqi nga subjekti politik Serbska Lista. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Lipjanit, e dorëhequra Safete Emërllahu, zëvendësohet nga Gentiana Hoxhaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Lipjanit, e dorëhequra Hyra Bytyqi, zëvendësohet nga Venhar Agushi nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, i dorëhequri Fatmir Iskaj, zëvendësohet nga Afrim Berisha nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Decanit, i dorëhequri Sami Cacaj, zëvendësohet nga Ferki Cufaj nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, i dorëhequri Ali Morina, zëvendësohet nga Arbër Zenuni nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Pejës, i dorëhequri Fatmir Asllani, zëvendësohet nga Islam Hysaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Pejës, i dorëhequri Arianit Krasniqi, zëvendësohet nga Luan Pavata nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Pejës, i dorëhequri Agron Nikqi, zëvendësohet nga Granit Kelmendi nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Pejës, e dorëhequra Xhenete Syka-Kelmendi, zëvendësohet nga Dafina Dragaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Pejës, e dorëhequra Albulena Mujaj-Bajraktaraj, zëvendësohet nga Gentiana Fetaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, i dorëhequri Ali Duraku zëvendësohet nga Artan Asllani nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, i dorëhequri Afrim Dina, zëvendësohet nga Hasan Terboqi nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, i dorëhequra Saranda Sallteku, zëvendësohet nga Doruntina Sopjani nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Prizrenit, i dorëhequri Kujtim Gashi, zëvendësohet nga Sulltan Badallaj nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Prizrenit, i dorëhequri Nehat Elshani, zëvendësohet nga Driton Daci nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën Mitrovica e jugut, i dorëhequri Valon Brahimi, zëvendësohet nga Hamdi Hasani nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën Mitrovica e jugut, i dorëhequri Fahri Shabani, zëvendësohet nga Egzon Hamza nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën Mitrovica e jugut, e dorëhequra Igballe Islami, zëvendësohet nga Rafije Rexha nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Novobërdës, i dorëhequri Xhevat Mehemti, zëvendësohet nga Pranvera Kastrati-Gashi nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Suharekës, i dorëhequri Enver Shabani, zëvendësohet nga Saranda Bajraktari nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Suharekës, e dorëhequra Besa Kuqi, zëvendësohet nga Mimoza Bajraktari nga subjekti politik PDK. Kush është për...?

Miratohet...

## **2.Këshilli i Personelit:**

Diskutim lidhur me pozitën e zv. Krye shefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së:

**Sami Kurteshi:** E kemi shqyrtuar edhe një propozim të ZRPP-së, dhe aty është edhe një rekomandim. Propozoj që më shumë, të flasim nga zyra...

**Valmira Selmani (ZRPP),** tha se zyra ka përgatitë draft-rekomandimin për caktimin e lartësisë së mjeteve nga fondi për përkrahjen e subjekteve politike për vitin 2022. Pjesë e këtij rekomandimi, është edhe ndalesa e borxhit për subjektet politike, e ku ne i kemi drejtuar edhe PZAP-së dhe ata na kanë njoftuar se cilat subjekte kanë borxhe...

E keni tabelën, janë të gjitha detajet lidhur me këtë raport...

Në këtë pikë, diskutuan, kryesisht për çështje teknike të rekomandimit: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e këtij draft-rekomandimi ?

Miratohet unanimisht.

## **3.Aktivitetet e ZRPP-së**

Në vazhdim të mbledhjes, Valmira Selmani (ZRPP), e informoi KQZ-në lidhur me një kërkesë që e ka pranuar zyra, dhe që vjen në emër të grupit parlamentar multietnik. Ajo tha se, kërkesa ka të bëjë me mjetet, transferimin e tyre...

Sami Kurteshi, tha se KQZ ka marrë vendim në vitin e kaluar që ato tu barten subjekteve parlamentare. Ky grup, kërkon që mjetet si në të kaluarën, tu barten deputetëve. KQZ, nuk ka ndonjë nevojë që t'i ndryshoj vendimet e veta. Këshilli, konsideron që nuk duhet shkaktuar precedent, dhe duhet vazhduar sipas vendimit i cili, qe marrë me kërkesën e subjekteve parlamentare...

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, kush është për që kjo kërkesë e Grupit Multietnik në Kuvendin e Kosovës, të refuzohet...?

KQZ, vendosi që kjo kërkesë të refuzohet.

#### **4.Komiteti i Auditimit**

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të KA për vitin 2021:

**Sami Kurteshi:** E kemi përgatitur raportin dhe, e kemi edhe në rend dite. Është një përmbledhje e aktiviteteve të auditimit: ka miratuar dokumentet bazë, ka mbajtur deri më tash 4 takime, ka trajtuar edhe çështje të brendshme të auditorit të KQZ-së, raportit i janë bashkangjitur edhe tabelat etj.

Nëse keni pyetje, urdhëroni.

**Alim Rama:** Në raport, nuk ishte çështja e produkteve të covid. Ne, e kemi një raport të auditorit të brendshëm, i cili ka konstatuar shkelje. C'ka është bërë me këtë raport...?

**Sami Kurteshi:** Ne, e kemi shqyrtuar dhe ajo që është konstatuar, është se ka pasur shkelje zinxhirore. Raporti është miratuar, dhe unë si kryesues, ky raport të shkojnë në institucionet hetimore. Nuk kemi marrë këtë vendim, ashtu si edhe vetë KQZ. Personalisht, unë kam thënë se ky raport duhet të shkoj në prokurori, dhe besoj që tash është hapur rruga...Unë, qoftë me kërkesë të KQZ-së dhe qoftë pa te, unë do t'i dërgoj në prokurori...

Në këtë pikë, diskutuan: **Alim Rama**, i cili kërkoi që KQZ ta dërgoj në prokurori. Mund edhe të votojmë....! **Kreshnik Radoniqi**, tha se ky është veprimi më i lehtë i mundshëm, secili e ka këtë mundësi. Por, ne se kemi obligim. Raportet tha ai, janë publike...

**Sami Kurteshi**, tha se ky nuk është raport publik, por intern! Dhe në raport, ka shkelje. Në fjalën e tij, z. Kurteshi e arsyetoi relacionin e brendshëm, ashtu si edhe qëndrimin e tij si pjesë e KQZ-së se, pse ky raport duhet të shkoj në prokurori... **Arianit Elshani**, tha se ka pasur edhe të tjera raporte nga auditori i brendshëm, madje kemi dërguar edhe në MEF, ashtu siç ka pasur edhe dërgim të raporteve në prokurori. Mendoj që, mund të vazhdojmë në këtë drejtim edhe me raste të tjera. Cilin do variant, e mbështesim..

**Ibrahim Selmanaj**, e analizoi çështjen, dhe tha se aty ku ka shkelje të rënda, duhet të bëhen edhe hetime. Mendoj që krye shefi, duhet ta ketë rolin menaxhues, dhe kryesisht, nuk duhet përsëritur gabimet. Ne, jemi të hapur, por përshtypja ime është që KQZ nuk duhet të dërgoj lëndë në prokurori, ndërsa që mekanizmat në KQZ të jenë në trend të përgjegjësive të veta.

**Burim Ahmetaj**, tha se ne si Sekretariat kemi marrë udhëzimet e komitetit të auditimit, dhe kemi marrë masat tona, dhe jemi vlerësuar në këtë drejtim! Kemi marrë, të gjitha masat e mundshme...

**Sami Kurteshi**, nuk u pajtua me masat e ndërmarra, përkundrazi...!

**Florian Dushi**, tha se është gjithçka t'i nënshtrohet aspektit ligjor, mirëpo duhet pasur kujdes që të mos cenohet dinjiteti dhe integriteti i secilit, të jemi të përmbytur dhe të mos cenohet askush dhe, as të mos prezumohet pafajësia se[se, kjo është e mbrojtur me ligj dhe kushtetutë! Pra, të jemi të kujdesshëm në vlerësime, në konstatime, të mos paragjykojmë etj.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është që ky raport të dërgohet në prokurori ?

Me 3 vota për (Sami Kurteshi, Alim Rama dhe Fazli Stollaj), dhe 4 vota abstenim ( Čemailj Kurtiši, Ibrahim Selmanaj, Kreshnik Radoniqi, Rifat Krasniq), nuk miratohet ! Florian Dushi dhe Arianit Elshani, nuk morën pjesë në votim.

*P. s. Mbledhja vazhdoi me duar të mbyllura.*

5. **Diskutim lidhur me pozitën e zv. Krye shefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së:**

**Për KQZ**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar**

=====